

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT / MINISTARSTVO KULTURE OMLADINE I SPORTA
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
AGJENCIA SHETËTORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS / DRŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA
STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES

Nr./Br./No. 01/65/24

Data/Datum/Date: 07.03.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sport
Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës/ Državna Agencija Kosovskih Arhiva/ Kosovo State
Archives Agency

Nr: 23/2024

Datë: 07.03.2024

Duke marrë parasysh nenin 12, 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), në pajtim me nenin 5 të Ligjit Nr.08/L – 111 për Arkivat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 30 / 5 shtator 2022), Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Bislim Bislimi, nxjerr;

V E N D I M

1. Themelohet regjistri zyrtar i vulave të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (këtu e tutje: ASHAK) me të cilat vërtetohen kopjet e materialeve të ofruara për shfrytëzim nga personat juridik dhe fizik, publik dhe jo publik, në arkivin qendror dhe në arkivat ndërkomunale, pjesë e rrjetit arkivor, përkatësisht të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.
2. Regjistri i vulave mbi kopjet e vërtetuara të materialeve arkivore nga njësitë organizative arkivore të ASHAK, përmbajnë së paku të dhënat si në vijim: datën e vulës, numrin rendor, numrin e fondit, emrin e fondit, numrin dhe emrin e njësive tjera integrale të fondit të caktuar, llojin e materialit të ofruar, si dhe numrin e faqeve që përmban kopja e vërtetuar.
3. Pas hyrjes në fuqi të këtij akti administrativ, kopjet e materialeve arkivore që nuk përmbajnë vulë zyrtare identike me të dhënat nga regjistri zyrtar i vulave në ASHAK, nuk kanë cilësi të dokumentacionit të vërtetuar në arkivin kompetent, gjegjësisht, institucionin kompetent, rrjedhimisht, nuk mund të fitojnë cilësinë e dokumentacionit zyrtar që mund të përdoret në çfarëdo procedure gjyqësore apo administrative.
4. Materiali arkivor më i vjetër se tridhjetë (30) vjet, i pa dorëzuar ende në ASHAK dhe që gjendet tek arkivat e fondkrijuesve, mund të ofrohet për shfrytëzim për palët nga personat kompetent të arkivave të fondkrijuesve, vetëm pasi të nënshkruhet marrëveshje e bashkëpunimit me ASHAK, me të cilën, delegohet autoriteti zyrtar për të vërtetuar kopjet e materialeve sipas rregullave dhe standardeve paraprakisht të definuara në marrëveshje, deri në dorëzim – pranimin përfundimtar të materialit arkivor të rregulluar në ASHAK, sikurse obligon neni 13 i Ligjit Nr.08/L – 111 për Arkivat.
5. Ky vendim nuk zbatohet për arkivat e institucioneve publike/private që në përputhje me nenin 10 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 08/L – 111 për Arkivat, kanë autorizime ligjore për të funksionuar si arkiva speciale, respektivisht:
 - 5.1. Ministria e Mbrojtjes;
 - 5.2. Ministria e Punëve të Brendshme;
 - 5.3. Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës;
 - 5.4. Agjencia Kosovare për Inteligjencë;

5.5. Institucionet publike dhe private të arsimit të lartë;
5.6. Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës.

6. Ky vendim nuk zbatohet për arkivat private që në përputhje me nenin 11 të Ligjit Nr. 08/L – 111 për Arkivat, kanë autorizime ligjore për të funksionuar si arkiva private.
7. Deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, arkivi qendror dhe arkivat ndërkomunale obligohen të zbatojnë detyrat konkrete për të zbatuar pikën një (1) dhe dy (2) të këtij Vendimi, respektivisht të krijojnë formatin unik të regjistrimit zyrtar të vulave dhe të harmonizojnë shënimet e vulave zyrtare aktuale me kërkesat e pikës dy (2) të këtij Vendimi.
8. Vendimi publikohet në mjetet e komunikimit online që janë në përdorim të ASHAK –së dhe në çdo hapësirë tjetër ku palët kanë qasje gjatë parashtrimit të kërkesave për shfrytëzim të materialit arkivor në arkivin qendror dhe në arkivat ndërkomunale.
9. Vendimi hyn në fuqi më datë 25 mars 2024.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv të ASHAK;
- Drejtorëve të departamenteve të ASHAK;
- Arkivave ndërkomunale të ASHAK;
- Institucioneve të administratës shtetërore;
- Institucioneve të pavarura kushtetuese;
- Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës;
- Këshillit Prokurorial të Republikës së Kosovës;
- Agjencive të pavarura;
- Komunave të Republikës së Kosovës.

